



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*

*Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija*

*Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve që mbështesin dhe promovojnë nxënësit rom,  
ashkali dhe egjiptian në qendrat mësimore

## Udhëzime për aplikuesit

Data e hapjes të thirrjes: **15 Prill 2022**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve: **20 Maj 2022 në orën 16.00**

## Përmbajtja

1. Mbështetje financiare për projekte të OJQ-ve që mbështesin dhe promovojnë nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian në qendrat mësimore	2
1.1 Problemet që synohen të adresohen përmes kësaj thirrje publike	2
1.2 Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare	3
1.3 Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projekte dhe shuma e përgjithshme e thirrjes	4
2. Kushtet formale të thirrjes	4
2.1. Aplikuesit me të drejtë aplikimi: kush mund të aplikojë?	4
2.2 Partnerët që kualifikohen për zbatim të projektit / programit	5
2.3 Aktivitetet që kualifikohen për financim përmes kësaj thirrjeje	5
2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen nëpërmjet thirrjes	6
2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme	6
2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme	7
2.4.3 Shpenzimet e papranueshme	7
3. Si të aplikoni?	8
3.1 Formulari i projektpropozimit	8
3.2 Përmbajtja e formularit të buxhetit	8
3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?	9
3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikimeve	9
3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?	10
4. Vlerësimi dhe ndarja e fondeve	10
4.1 Aplikimet e pranura do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:	10
4.2 Dokumentacioni shtesë dhe nënshkrimi i kontratës	11
5. Kalendari indikativ i realizimit të thirrjes	12
6. Lista e dokumenteve të thirrjes publike	12

## 1. Mbështetje financiare për projekte të OJQ-ve që mbështesin dhe promovojnë nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë në qendrat mësimore

### 1.1 PROBLEMET QË SYNOHEN TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

Arsimimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës në Kosovë karakterizohet me pjesëmarrje të pakënaqshme në arsimin e detyrueshëm dhe pjesëmarrje shumë të ulët në arsimin e mesëm dhe të lartë. Shkalla e shkrim-leximit është një tregues i qartë i mospërputhjes midis komuniteteve shumicë dhe atyre joshumicë. Krahasuar me rreth 98 për qind të popullsisë së gjithmbarshme që di shkrim e lexim, vetëm 64 për qind e grave romë, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës dhe rreth 81 për qind e burrave të moshës 15-49 vjeç mund të lexojnë e të shkruajnë. Shkaqet rrënjësore të shkallës së ulët të arsimimit janë kushtet e rënda socio-ekonomike dhe rolet mbizotëruese gjinore në mesin e këtyre komuniteteve. Shpesh, fëmijët detyrohen të punojnë për t'u ndihmuar familjeve të tyre, ndërsa në rastin e vajzave efekt negativ kanë dhe martesat e hershme. Indeksi i barazisë gjinore për arsimin fillor është 1.01, që tregon se më shumë vajza sesa djem ndjekin shkollën fillore. Ky indeks bie në mënyrë dramatike në shkollën e mesme. Në arsimin e mesëm të ulët indeksi është 0.94, e në arsimin e mesëm të lartë indeksi është 0.80, që do të thotë se më pak vajza vazhdojnë ose përfundojnë shkollimin e tyre.

Infrastruktura ligjore për arsimimin, aftësimin dhe mbështetjen e nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk i plotëson në mënyrë të kënaqshme nevojat e këtij grupi të synuar. Për momentin arsimimi, aftësimi dhe mbështetja e këtij grupi fëmijësh bazohet në sa vijon dhe jo vetëm:

- Ligjin nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 40.
- Udhëzimin administrativ nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore.
- Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve 1989.
- Deklaratën e Salamankës e UNESCO-s e vitit 1994.
- Kornizën e kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës.

Arsimimi i nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian bazohet njëherazi dhe në parimet ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve si gjithëpërfshirja, mosdiskriminimi, barazia, arritja e potencialit, mbrojtja etj. Tërë këto parime duhet të respektohen në mënyrë që këta nxënës të ndihen të përmbushur në kuptimin e arritjes së potencialit të tyre.

Duke mbajtur parasysh arritjet e dobëta arsimore, qendrat mësimore e kanë plotësuar tradicionalisht boshllëkun me qëllim të ofrimit të shërbimeve arsimore plotësuese. Si model plotësues i zhvillimit dhe edukimit, qendrat mësimore ndajnë një qëllim të përbashkët – t'i mbajnë fëmijët në shkollë, të lehtësojnë pjesëmarrjen e tyre në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët dhe të arrijnë rezultate më të mira akademike. Qendrat mësimore janë promovuar për t'u shërbyer kryesisht komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, megjithatë me kalimin e viteve ato u zgjeruan për të t'u shërbyer dhe fëmijëve nga radhët e komuniteteve të tjera. Kjo thirrje synon përfituesit e qendrave mësimore në Kosovë.

## 1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Objektivë e përgjithshme e kësaj thirrje për propozime është mbështetja e fëmijëve dhe nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në qendrat mësimore.

Objektivë specifike e kësaj thirrje për propozime është përmirësimi i rezultateve të të nxënësve dhe pjesëmarrjes në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët, përmes mësimin plotësues dhe mbështetjes për fëmijët dhe nxënësit rom, ashkali, egjiptian dhe të tjerë.

### **Prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare:**

Projektet duhet të trajtojnë një ose më shumë prioritetet të mëposhtme:

- Rritjen e shkallës së arritjes në mësim dhe të vijueshmërisë së nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë.
- Ngritjen e kapaciteteve të stafit të qendrës mësimore në ofrimin e mësimin cilësor për fëmijët që e vijojnë atë;
- Ndërgjegjësimin për rëndësinë e shkollimit të detyrueshëm;
- Përmirësimin e bashkëpunimit mes qendrave mësimore, shkollave dhe drejtorive komunale të arsimit.

## 1.3 VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTE DHE SHUMA E PËRGJITHSHME E THIRRJES

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të ndahet për çdo projekt individual është 10,000 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 100,000 €. Shuma maksimale për një qendër mësimore të mbuluar me një projekt është 25,000 €.

Projektet mund të financohen në masën 95% të kostove totale të pranueshme të projektit. Aplikuesit dhe partnerët e mundshëm duhet të sigurojnë bashkëfinancim nga burime të financimit që nuk janë nga Qeveria e Kosovës ose në natyrë (përfshirë vullnetarizmin).

Për financimin e projekteve sipas kësaj thirrje publike, parashihet shuma në dispozicion prej 200,000 euro.

## 2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

### 2.1 Aplikuesit me të drejtë aplikimi: kush mund të aplikojë?

Aplikuesi duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

1. të jetë organizatë joqeveritare e regjistruar në përputhje me Ligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare së paku tri (3) vite para publikimit të kësaj thirrje;
2. të ketë zotësi juridike, financiare dhe operationale për zbatimin e projektit;
3. të ketë së paku dy (2) vite përvojë në menaxhimin e qendrave mësimore dhe në zbatimin e projekteve nga fushat prioritare të thirrjes publike;
4. qendrat mësimore për të cilat aplikon duhet të jenë të regjistruara në MASHTI në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MASHT Nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore;
5. të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet e tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
6. të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
7. Të mos ketë shkelur kushtet e përcaktuara të përdorimit të fondeve publike.

Të mëposhtmit **nuk** kanë të drejtë të konkurrojnë në këtë thirrje:

1. OJQ-të që nuk i kanë shpenzuar mjetet nga mbështetja e mëparshme financiare publike për qëllimin për të cilin janë dhënë;
2. OJQ-të që mund të kenë konflikt interesi.

Numri i projekteve për të cilat mund të aplikojë një OJQ:

1. Një aplikues mund të paraqesë një projektpropozim.
2. Një aplikues NUK mund të jetë njëkohësisht partner në një aplikim tjetër.

### 2.2 Partnerët që kualifikohen për zbatim të projektit / programit

1. Në rast të partneritetit, partnerët mund të marrin pjesë në më së shumti një aplikim.

Partnerët duhet t'i plotësojnë të gjitha kriteret e përshtatshmërisë të zbatueshme për aplikuesit, siç përcaktohet në pikën 2.1 të këtij udhëzuesi.

Me rastin e aplikimit, aplikuesi duhet të ketë arritur një marrëveshje partneriteti me OJQ-të partnere. Për këtë qëllim, duhet të nënshkruhet një deklaratë partneriteti nga secili partner në projekt dhe e njëjta të dorëzohet.

### 2.3 Aktivitetet që kualifikohen për financim përmes kësaj thirrjeje

1. Kohëzgjatja e planifikuar e projektit është nga gjashtë (6) deri në dhjetë (10) muaj, duke filluar nga Shtatori 2022.
2. Aktivitetet e projektit duhet të realizohen në territorin e Republikës së Kosovës.
3. Aktivitetet e projektit që i plotësojnë kriteret për financim mund të përfshijnë:
  - Aktivitete edukative plotësuese për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ndër të tjerë;
  - Aktivitetet arsimore dhe socio-emocionale për grupin përfitues përmes sportit, artit dhe kulturës për të rritur njohuritë dhe aftësitë;
  - Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të stafit të qendrës mësimore për të siguruar funksionimin efektiv të qendrës mësimore dhe dhënien e mësimave cilësore;
  - Aktivitete për ndërgjegjësimin e prindërve për rëndësinë e arsimit të detyrueshëm dhe të mëtejshëm;
  - Aktivitete që synojnë nxitjen e bashkëpunimit më të mirë mes qendrës mësimore, autoriteteve lokale dhe shkollave;
  - Aktivitete në mbështetje të arritjes së standardeve minimale për t'u regjistruar në MASHTI.

Lista e aktiviteteve të projektit nuk është shteruese, porse vetëm ilustruese dhe do të merren parasysh për financim edhe aktivitete të tjera të përshtatshme që kontribuojnë në arritjen e objektivave të përgjithshme dhe specifike të thirrjes e që nuk janë përmendur në listën më sipër.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, aplikuesi duhet të sigurohet se ato bazohen në parimin e mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, si dhe të zhvillojë aktivitete në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetarëve.

4. Llojet e mëposhtme të aktiviteteve **nuk** i plotësojnë kriteret për financim:
  - Aktivitetet që kanë të bëjnë ekskluzivisht ose kryesisht me pjesëmarrjen individuale në seminare, konferenca, kongrese dhe punë hulumtuese;
  - Aktivitetet që kanë të bëjnë ekskluzivisht ose kryesisht me bursa individuale për studime ose punëtori;

- Aktivitetet të cilat nuk kanë të bëjnë me arritjen arsimore të nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Aktivitetet në të cilat përfitues të vetëm janë anëtarët e OJQ-ve aplikuese.

## 2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen nëpërmjet thirrjes

Përmes financimit publik të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të përcaktuar me këto udhëzime. Gjatë vlerësimit të projektit / programit do të vlerësohen vetëm kostot që lidhen me aktivitetet e planifikuara, si dhe shuma reale e këtyre shpenzimeve.

### 2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të drejtpërdrejta të pranueshme përfshijnë shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e disa aktiviteteve të projektit ose programit të propozuar, të tilla si:

- ✓ Organizimi i aktiviteteve edukuese (në veçanti duhet të identifikohet lloji dhe çmimi i secilit shërbim);
- ✓ Material didaktik;
- ✓ Material shpenzues;
- ✓ Shërbimet grafike (printimet paraprake, shërbime për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave etj., duke saktësuar llojin dhe qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin për njësi etj.);
- ✓ Shpenzimet për paga dhe pagesa për menaxherët e projektit / programit, stafin e projektit, ose partnerët e jashtëm të angazhuar në projekt (kontratat e të drejtave të autorit dhe të drejtave pronësore, kontrata tjera, kontrata pune), duke specifikuar emrat e personave të angazhuar, aftësitë e tyre profesionale, numrin e muajve të angazhimit të tyre dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- ✓ Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit etj.) këto shpenzime duhet të përcaktohen (specifikohen);
- ✓ Kostoja për prokurimin e pajisjeve të nevojshme për zbatimin e projektit / programit, e cila duhet të përcaktohet sipas llojit dhe shumës;
- ✓ Shpenzimet e udhëtimit (p.sh., mëditjet);
- ✓ Kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit ose programit;

### 2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

*Përveç shpenzimeve të drejtpërdrejta të pranueshme, në kuadër të kësaj thirrje do të pranohen edhe kostot e tërthorta deri në 7% të vlerës totale të kostove të drejtpërdrejta të pranueshme. Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që kontribuojnë në mënyrë të tërthortë në arritjen e objektivave të projektit. Këto kosto duhet të specifikohen dhe shpjegohen.*

### 2.4.3 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

- ✓ investime kapitale ose kredi për investime, fonde garancie;
- ✓ kostot e blerjes së pajisjeve, mobileve dhe punëve të vogla të ndërtimit nëse vlera tejkalon 10% të kostove totale të pranueshme të projektit;
- ✓ shpenzimet e interesit për borxhin;
- ✓ gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
- ✓ pagesa e bonuseve për punonjësit;
- ✓ kostot që tashmë janë financuar nga burime publike ose shpenzimet në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;
- ✓ blerja e pajisjeve të përdorura, makinerive dhe mobileve etj.;
- ✓ kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
- ✓ donacione bamirësie;
- ✓ hua për organizata ose individë të tjerë;
- ✓ kosto tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit;

### 3. SI TË APLIKONI?

*Aplikimi i OJQ -së do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjithë formularët e aplikimit dhe shtojcat e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si më poshtë:*

1. Formulari i projektpropozimit;
2. Formulari i propozim buxhetit;
3. Formulari i deklaratës së partneritetit (nëse aplikoni në partneritet);
4. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
5. Kopja e certifikatës së numrit fiskal të OJQ-së;
6. Deklarata që tregon mungesën e financimit të dyfishtë;
7. Formulari i deklaramit të zbatimit të projekteve të tjera të financuara nga burime publike
8. Deklarata e dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore;
9. Certifikatë nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e borxhit publik të aplikuesit dhe partnerëve që vërteton se organizata nuk ka borxh dhe në rast se ka borxh publik, duhet të paguhet para nënshkrimit të kontratës. Certifikata duhet të lëshohet brenda periudhës nga data e hapjes së thirrjes publike (ky dokument do të kërkohet para publikimit të rezultateve përfundimtare, dhe pas publikimit të rezultateve paraprake).

#### 3.1 Formulari i projektpropozimit



Plotësimi i formularit të projektpropozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ai përmban informacione për aplikuesin dhe partnerët, si dhe të dhëna për përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Nëse në formularin e dorëzuar mungojnë të dhënat rreth përmbajtjes së projektit, aplikimi nuk do të merret parasysh.

Formulari duhet të plotësohet në kompjuter. Nëse formulari është plotësuar me dorë, aplikimi nuk do të merret parasysh.

Nëse formulari përmban përshkrim të gabuar siç u përmend më lart, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

### **3.2 Përmbajtja e formularit të buxhetit**

Formulari i propozimbuxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim buxheti i paraqitur duhet të përmbajë informata për të gjitha shpenzimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse formulari i buxhetit nuk është plotësuar në tërësi, ose nuk është dorëzuar në formën përkatëse, aplikimi nuk do të merret parasysh.

Formulari duhet të plotësohet në kompjuter. Nëse formulari është plotësuar me dorë, nuk do të merret parasysh.

### **3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?**

Formularët e detyrueshëm dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohen në formë fizike, të shtypura (një origjinal) dhe në formë elektronike (në CD). Formularët e detyrueshëm duhet të jenë të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD duhet të vendosen në një zarf të mbyllur.

Aplikimi origjinal duhet të dorëzohet personalisht (dhe të dorëzohet në zyrën përkatëse). Në pjesën e jashtme të zarfit, shkruani emrin e thirrjes publike, së bashku me emrin dhe adresën e plotë të aplikuesit dhe shënimin " *Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues*"

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

*Ministria e Shkencës, Arsimit, Teknologjisë dhe Inovacionit*

*Rr. "Agim Ramadani", përdhësë, zyra nr. 4*

*"Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues"*

### **3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikimeve**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është **20 Maj 2022 në orën 16.00**. Nëse aplikimi dorëzohet personalisht në zyrë, aplikuesit do t'i lëshohet një vërtetim që aplikimi është pranuar brenda periudhës së shpalljes.

Të gjitha aplikimet e pranuar pas afatit nuk do të merren parasysh.

### **3.5 Kë të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?**

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar një kërkesë në adresën: **Nazan.Safqi@rks-gov.net**, jo më vonë se se më 4 Maj 2022.

Përgjigjet ndaj kërkesave të veçanta do të dërgohen drejtpërdrejt në adresën nga e cila janë parashtruar pyetjet, ndërsa përgjigjet më të shpeshta do të publikohet në faqen e internetit: <https://masht.rks-gov.net/> jo më vonë se më 6 Maj 2022.

Për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë aplikuesve të mundshëm, ofruesi i mbështetjes financiare publike nuk mund të japë një mendim paraprak për plotësimin e kushteve nga aplikuesit, partnerët, aktivitetet ose shpenzimet e cekura në kërkesë.

## **4 VLERËSIMI DHE NDARJA E MJETEVE**

### **4.1 Aplikimet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:**

4.1.1 Ofruesi i mbështetjes financiare do të themelojë një Komision Vlerësues në përbërje të 5 anëtarëve, të cilët janë zyrtarë nga institucioni dhe ekspertë të tjerë të jashtëm, detyra e të cilëve është të vlerësojnë nëse aplikimet i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të të gjitha aplikimeve të pranuar, Komisioni do të përgatisë një listë të të gjithë aplikuesve që i plotësojnë kushtet për të vlerësuar përmbajtjen e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikuesve që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Ofruesi i mbështetjes financiare do t'i njoftojë të gjithë aplikuesit të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë, Komisioni Vlerësues i përbërë nga pesë (5) anëtarë do të vlerësojë përmbajtjen e aplikimeve. Çdo aplikim i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

- Përvoja e organizatës(organizatave) aplikuese dhe stafit të saj, duke përfshirë në veçanti përvojën përkatëse në fushën me prioritet të kësaj thirrje (30 për qind);
- Shkalla në të cilën projekti i propozuar trajton objektivën e thirrjes. Propozimi duhet të dëshmojë një perspektivë gjinore të mirë integruar në të gjitha fazat e zbatimit të tij (30 për qind);
- Shkalla në të cilën projekti i propozuar përputhet me kërkesat e thirrjes (20 për qind);
- Rëndësia e përgjithshme, cilësia, qartësia dhe realizueshmëria financiare e propozimit dhe buxhetit të vlerësuar (20 për qind)

Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfituese të përzgjedhura për financim - Bazuar në vlerësimin e aplikacioneve që kanë plotësuar kushtet e përcaktuara në thirrje, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të renditura në listën e përkohshme nuk do të kalojë shumën totale të financimit përmes thirrjes publike.

Përveç listës së përkohshme, bazuar në pikët që janë dhënë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë dhe listën rezervë të projekteve/programeve.

## **4.2 Dokumentacioni shtesë dhe nënshkrimi i kontratës**

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkursin, ofruesi i burimeve financiare do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikues të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, janë përfshirë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit të kontratës përfundimtare, dhe bazuar në vlerësimin e Komisionit, ofruesi mund të kërkojë rishqyrtimin e formularit përfundimtar të buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Dokumentacioni shtesë që do të kërkohet: Vërtetim nga administrata tatimore se janë kryer të gjitha detyrimet tatimore.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse aplikuesi nuk dorëzon dokumentacionin shtesë të kërkuar brenda kohës së caktuar prej 10 ditësh, aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me thirrjen publike, ato aplikime nuk do të merren në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen nëse, pas kontrollimit të dokumenteve mbështetës dhe pasi të jetë konstatuar nga institucioni se ka mjete të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikuesit, aplikimet e të cilëve u janë nënshtruar procesit të vlerësimit do të njoftohen lidhur me vendimin për ndarjen e projekteve/programeve kuadër të thirrjes.

## 5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat procedurale të thirrjes

1. Afati i fundit për aplikimet: 20 Maj 2022
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen: 4 Maj 2022
3. Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve në pyetjet që lidhen me thirrjen: 6 Maj 2022
4. Afati për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret procedurale dhe njoftimin e palëve: 2 Qershor 2022
5. Afati për vlerësimin përmbajtësor të aplikimeve: 14 Qershor 2022
6. Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë: 21 Qershor 2022
7. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar: 29 Qershor 2022
8. Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimin e aplikuesve: 12 Korrik 2022
9. Afati për kontraktim: 26 Korrik 2022

Financuesi ka të drejtë të përditësojë kalendarin indikativ. Duhet ta dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e internetit: [www.masht.rks.gov.net](http://www.masht.rks.gov.net)

OSBE në bashkëpunim me MASHTI do të ofrojë mbështetje për OJQ të cilat drejtojnë qendrat mësimore, duke organizuar sesione informuese.

Sesioni informues do të organizohet më 27 Prill 2022, ndërsa për vendin dhe kohën do të njoftoheni me kohë përmes e-mailit.

## 6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

FORMULARËT

1. *Formulari i aplikimit për projekt/program (F9)*
2. *Formulari për propozim buxhetin (F10)*
3. *Formulari për deklaratën për mungesë të financimit të dyfishtë (F11)*

4. *Formulari i deklaratës së partneritetit (F12)*
5. *Formulari i deklaratës së projekteve të financuara nga fondet publike (F13)*
6. *Formulari për vlerësimin e aplikacioneve (F15)*
7. *Formulari i modelit të kontratës (F16)*